



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## **INTERVISTË E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH, ME “ALBANIAN SCREEN”**

*Intervistoi: Elona Gjylmi*

**Z. Ambasador sot skadon mandati i komisionit të reformës zgjedhore. Kjo është shtyrja e tretë, por duket se tashmë situata është më e acaruar se kurrë ndonjëherë gjatë punimeve të këtij komisioni. Mund të flasim për dështim?**

**Ambasadori Wollfarth:** Puna e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën e Kodit Zgjedhor ishte dhe është shumë intensive, sepse ata do të takohen gjatë ditës për të përmbledhur atë çka kanë bërë deri tani. Është shënuar një progres shumë i rëndësishëm në hartimin e ndryshimeve të propozuara dhe më vonë do të duhet të merret një vendim në seancë plenare. Me lejoni të theksoj se sa i përket listës së zgjedhësve, procedurës së votimit, numërimit të votave dhe barazisë gjinore, për të përmendur vetëm disa prej çështjeve, janë bërë shumë propozime të rëndësishme dhe është rënë dakord paraprakisht deri tani. Unë do ta shihja më tepër si një histori suksesi, e cila vazhdon, ende nuk ka përfunduar. Kjo ishte pjesa e tretë e afatit të Reformës së Kodit Zgjedhor, pas dy shtyrjeve të mëparshme. Pjesa tjetër i takon tani komisionit parlamentar të ligjeve dhe seancës plenare për të marrë vendim. Unë do të ftoja për një veprim të qartë dhe të shpejtë, pasi nevojitet qartësi për përgatitjen e zgjedhjeve të ardhshme dhe akrepat e orës po afrohen. Qytetarëve të zakonshëm mund t'u duket se deri në zgjedhje ka kohë, por është shumë e rëndësishme që të bëhen përgatitjet, të cilat kanë nevojë për kohën e tyre. Përveç kësaj, njerëzit duhet të njihen edhe me Kodin e ri, prandaj unë bëj thirrje për një vazhdim të shpejtë të asaj që unë do ta konsideroja një punë shumë të suksesshme të Komisionit të Posaçëm.

**Një tjetër konsensus i cili u trumbetua fuqishëm gjatë punës së këtij komisioni ishte ai për përdorimin e teknologjisë në zgjedhjet e ardhshme. Por ODIHR-i e ka parë të pavend përdorimin e numërimit elektronik dhe të identifikimit elektronik të zgjedhësve. Nuk është gati Shqipëria për një hap të tillë?**

**Ambasadori Wollfarth:** OSBE/ODIHR-i kanë vërtet një përvojë shumë të gjerë në këtë fushë. Ata janë të pranishëm gjatë zgjedhjeve dhe përgatitjeve për to në shumë vende, disa prej të cilave janë demokraci tipike perëndimore, të tjera demokraci të reja në zhvillim, kështu që ajo çka ata rekomandojnë bazohet në përvojën e tyre. Kur fut në përdorim një sistem të ri që kërkon marrjen e hapave kompleksë, këtyre hapave u duhet dhënë koha e nevojshme, duke krijuar kështu gradualisht edhe kapacitetet për instalimin e një sistemi të tillë kompleks. Dhe koha për këtë, duke iu kthyer sërish akrepave të orës, po ecën, gjërat po ndryshojnë, dhe duhen ndërmarrë shumë hapa finalizues për vënien në zbatim të këtij sistemi edhe këtu në Shqipëri. Pra, ajo çka bëri ODIHR-i ishte dhënia e një këshille bazuar në përvojën e tij, për të garantuar sukses. Suksesi është ajo çka meriton Shqipëria, suksesi është ajo që u nevojitet qytetarëve shqiptarë. Kjo është gjithashtu edhe ajo çka do t'i nevojitet edhe parlamentit të ri që do të dalë nga zgjedhjet e ardhshme parlamentare, për të mos pasur

përsëri çrregullime dhe bllokime. Pra, nevojitet një sukses dhe kjo vjen me një qasje hap pas hapi, duke mos i bërë të gjitha gjërat në të njëjtën kohë.

**Pra sipas mendimit tuaj palët duhet të tërhiqen nga ky konsensus, apo të plotësojnë bazën ligjore që e kanë tashmë nëpër duar, duke shmangur çdo lloj mundësie manipulimi?**

**Ambasadori Wollfarth:** E rëndësishme për të gjitha zgjedhjet është ekzistenca e vullnetit politik për të respektuar rregullat e lojës. Pajisjet mund të ndihmojnë, si për shembull me numërimin elektronik të votave nëpërmjet lexuesve elektronikë dhe kjo është pika e rëndësishme e nisjes. Unë do të doja që vullneti politik të ishte më i fortë dhe do të doja të shihja më shumë vullnet të tillë për zgjedhjet e ardhshme. Politikanët kanë një ndikim të madh mbi mbështetësit e tyre dhe krijimi i besimit të nevojshëm te qytetarët fillon nga drejtuesit e tyre, dhe është pikërisht ky besim, për të cilin unë do të bëja thirrje. Krijimi i besimit, i cili fillon me arritjen e konsensusit. Konsensusi vjen përmes dialogut, komunikimit, prezantimit të ideve të mira dhe të realizueshme, verifikimit dhe rivefikimit të këtyre ideve, dhe përpilimit të teksteve të legjislationit në mënyrë të përbashkët, sepse ajo çka i nevojitet vendit është një sërë zgjedhjesh në frymën e demokracisë. Pra, kjo është qartazi një çështje ku nevojitet konsensusi më i gjerë i mundshëm, bazuar në kompromis dhe kjo do të thotë ndryshime të hartuara bashkërisht. Prandaj, puna e bërë deri tani në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore është e shkëlqyer, puna e përbashkët, e cila përfshin kampet kryesore politike, duke mos u kufizuar vetëm në dy parti politike, çka është shumë e rëndësishme. Shohim elementë jashtëzakonisht të mirë në draftet e tyre, por mbeten ende disa çështje, që në krahasim me të tjerat unë do t'i quaja më të vogla, të pazgjidhura. Pra, unë shoh të gjitha shanset e nevojshme që së shpejti të shohim një reformë të mirë të Kodit Zgjedhor në Shqipëri dhe kjo perspektivë më bën të lumtur. Mendoj se kjo është ajo çka meriton Shqipëria.

**Një tjetër çështje se duket se ka bllokuar punimet e komisionit edhe në ditët e tij të fundit është edhe administrata zgjedhore. Mendoni se do të ishte një formulë e suksesshme ajo e propozuar nga Partia Socialiste për të pasur kryetarin e KQZ-së si propozim të Avokatit të Popullit, Presidentit dhe institucioneve të tjera?**

**Ambasadori Wollfarth:** Propozime të tilla nënkuptojnë kthimin, të paktën pjesërisht, në sistemin e mëparshëm, ku Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk emërohej vetëm nga partitë. Ka arsye të mira për këtë, por kjo gjë është ndryshuar nga vetë partitë nëpërmjet vendimit të tyre të fundit. Ajo çka i duhet Shqipërisë është që të shohë përpara për t'i marrë vendimet me një perspektivë afatgjatë dhe jo të ndryshojë gjithçka në çfarëdolloj kohe sipas dëshirës së njerëzve. Nevojitet më shumë përgjegjësi, më shumë perspektivë afatgjatë, dhe ajo që ne presim si komunitet ndërkombëtar, pasi kjo çon edhe në paqe sociale dhe paqja tashmë nuk kufizohet vetëm në një vend të caktuar. Ajo që ne presim të shohim është një punë e mirë teknike e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke dhënë një tablo të qartë të asaj çka duan saktësisht zgjedhësit në ditën e zgjedhjeve, dhe e përsëris, saktësisht. Kjo është punë teknike dhe nuk duhet të jetë nën asnjë lloj ndikimi politik. Nëse politikanët mund ta garantojnë këtë, në rregull. Nëse nuk e garantojnë, ata duhet të shohin të gjitha pikëpyetjet dhe pasojat e tyre dhe t'ua lënë në dorë qytetarëve që të reagojnë siç duhet. Të gjithë, jo vetëm në Shqipëri, duhet ta kenë këtë parasysh.

**Kthimi prapa në sistemin e vjetër do të ishte i dëmshëm për KQZ-në do të ishte i dëmshëm apo edhe mund të garantojë një lloj besimi?**

**Ambasadori Wollfarth:** Për besimin nuk ka garanci. Besimi është diçka që duhet ndërtuar dhe ai vjen përmes dialogut, bashkëpunimit, dhe respektimit të rregullave të lojës. Ajo që vendi duhet të shohë është një Komision Qendror Zgjedhjesh që bën një punë të mirë teknike pa ndërhyrje, sepse ndërhyrjet në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndërsa ata janë në proces pune, është pothuajse njësoj sikur të ndërhysh në punën e policisë apo të ndërhysh në gjykimin e gjykatës. Pra, ata duhet të jenë në gjendje të punojnë dhe të bëjnë punën e tyre teknike, e cila konsiston në përgatitje dhe punë të përpiktë edhe pas zgjedhjeve. Nëse partitë politike bien dakord mbi një platformë që e lejon këtë gjë, atëherë gjithçka është në rregull. Nëse ka mangësi, ato duhen rishikuar. Tani gjithë përbërësit ekzistojnë për të bërë përgatitje të mira për zgjedhjet e ardhshme parlamentare dhe unë sigurisht që bëj thirrje që të përdoret siç duhet kjo platformë. Dilni me një platformë, finalizojeni atë, merrni një vendim dhe pastaj respektoni rregullat.

**Fund**